



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Prot. 57 Nr.

Durrës, më 09/01 / 2026

VENDIM

Nr. 01, datë 09.01 2026

"PËR SHTYRJEN E AFATIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE DOKTOR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE FAKULTETIN E SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE"

Bazuar në ligjin Nr.80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46; në Statutin e UAMD-së neni 30; në Rregulloren së UAMD-së neni 19 ; në nenin 23 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024; Urdhrit të Rektorit nr. 579, datë 03.12.2025, të Vendimit KIZ nr.10, datë 23.12.2025 ; Vendimit KIZ nr.11, datë 23.12.2025; kërkesave të Kryetareve të KZF FSHPJ dhe KZF FE mbi situatën e krijuar si pasojë e kushteve atmosferike përcjellë me email datë 08.01.2026, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit për regjistrimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" në Fakultetin e Edukimit dhe në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike, për shkak të situatës së krijuar nga kushtet atmosferike të datës 06.01.2026. Duke qenë se kjo situatë ka ndikuar në aksesin dhe mundësinë e stafit akademik për të aplikuar në kohë, u gjykua e arsyeshme dhe e nevojshme shtyrja e afatit të aplikimeve, me qëllim garantimin e barazisë dhe korrektesisë së procesit.
2. Afati i aplikimeve shtyhet deri me datë **14.01.2026** pranë **sekretarisë së KZF së Fakultetit të Edukimit dhe KZF së Fakultetit të Shkencave Politike Juridike**.
3. Për përmbushjen brenda afateve të procedurave të mëtejshme të cilat ky proces zgjedhor kërkon KZF duhet të përcjellin në KIZ vendimet respektive për miratimin e listës së kandidatëve **brenda datës 14.01.2026**.
4. Ngarkohet KZF e FE dhe KZF e FSHPJ për marrjen e masave për vazhdimin e procedurës përkatëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Ada GASHI

